

TERMAT E GARANCISË STANDARDE

PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET E OFRUARA NGA RATECH sh.p.k.

1. Kjo garanci standarde specifikon termat dhe kushtet e garancisë për shitjen e produkteve të listuara në Tabelën 1 (më poshtë në këtë dokument: “*produkti*”). Të drejtat e parashikuara në këtë garanci vlejné vetëm për blerësin që ka blerë produkte drejtpërdrejt nga RATECH (më poshtë në këtë dokument: “*klienti*”).

2. Kjo garanci standarde vlen vetëm për produktet e blera më ose pas datës 1.1.2020. Kjo garanci standarde lexohet së bashku me “*Termt dhe kushtet e përgjithshme të punës së RATECH*” që janë aktualisht në fuqi ose me kushte të tjera, për të cilat është rënë dakord nëpërmjet kontratës mes RATECH dhe klientit, përfshirë kontratën e instalimit, integrimin, furnizimin, shpërndarjes ose shitjes. Përveçse kur specifikohet ndryshe në këtë garanci, çdo term ose shprehje e përkufizuar apo e përdorur tek termat interpretohet njëjloj në zbatimin e kësaj garancie dhe termave. Në të gjitha aspektet e tjera, termat mbeten të pandryshuara dhe kanë fuqi dhe efekt të plotë. Në rast konflikti mes kësaj garancie standarde dhe termave, kanë përparësi kushtet e kësaj garancie.

3. Në kushtet e kësaj garancie standarde dhe të termave (përfshirë përjashtimet, kufizimet dhe kushtet e përcaktuara aty), RATECH i garanton klientit që produkti nuk do të ketë defekte gjatë periudhës së kufizuar të garancisë, siç specifikohet më poshtë në Tabelën 1. Për qëllimet e kësaj garancie standarde, “*defekt*” (ose “*produkt me defekt*”) do të thotë që produkti ka një defekt në material ose në punën e kryer nga personeli i RATECH, i cili shkakton që produkti të mos funksionojë në përputhje me specifikimet e ofruara nga RATECH, duke u bazuar në një vlerësim të performancës së përgjithshme të produktit.

4. RATECH garanton që, nga data e dorëzimit të parë të produkteve deri në përfundim të afatit të vlefshmërisë së kontratës, ka dhe do të ruajë personelin e duhur, kompetencën, aftësitë dhe burimet e nevojshme për të ofruar shërbimet e kontraktuara nga klienti. RATECH garanton që shërbimet e ofruara prej tij, agjentëve ose nënkontraktorëve të tij do të kryhen në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Për më tepër, RATECH garanton se shërbimi i klientit, pjesët e këmbimit dhe shërbimi i mirëmbajtjes, përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen parandaluese, do të jenë të disponueshme gjatë të gjithë afatit të garancisë.

Produkti	Periudha
Produkte dhe sisteme sigurie. Kushtet e kësaj garancie nuk zbatohen për aksesoret e shitur më vete.	1 vit
Instalime dhe integrimi i produkteve dhe sistemeve. Kushtet e kësaj garancie nuk zbatohen për produktet dhe sistemet e instaluar apo integruar që nuk janë furnizuar nga RATECH.	1 vit

Tabela 1: Periudha e garancisë

5. Përveçse kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e palëve, periudha e garancisë fillon nga dita e dorëzimit ose e instalimit të produktit, cilado të jetë më vonë në kohë.

6. RATECH nuk ka detyrime sipas kësaj garancie standarde nëse klienti nuk ka përmbushur detyrimet e tij për pagesë sipas termave.

7. Në mënyrë që kërkesa të jetë e vlefshme sipas kësaj garancie standarde, klienti e njofton menjëherë me shkrim RATECH për çdo produkt me defekt përpara se të mbarojë periudha e garancisë për këtë produkt. Përveç kësaj, mund të kërkohet që RATECH të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj garancie standarde vetëm nëse plotësohen këto kushte:

7.1. klienti ka të disponueshme për inspektim faturën e blerjes së produktit;

7.2. klienti i paraqet pretendimet sipas kësaj garancie menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas zbulimit të defektit;

7.3. klienti vë në dispozicion të RATECH informacione të përshtatshme në lidhje me historinë e funksionimit të produktit, duke përfshirë të paktën:

7.3.1. datën e dorëzimit ose instalimit të produktit;

7.3.2. detajet e defektit (të pretenduar), përfshirë numrin dhe përqindjen e rasteve të mosfunksionimit;

7.3.3. detajet e aplikimit, vendndodhjes dhe kushtet aktuale të punës.

7.4. Klienti merr pëlqimin e RATECH për të kryer çfarëdo lloj testi me qëllim që të përcaktojë nëse ekziston një defekt.

7.5. Padia gjyqësore për pretendime të bazuara në këtë garanci paraqitet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda një (1) viti nga data e njoftimit të kërkesës sipas paragrafit 7.2. të kësaj garancie.

NUIS: L11521021S

8. Detyrimet e RATECH sipas kësaj garancie kufizohen në një prej këtyre opsioneve:

8.1. riparimin e produktit nëpërmjet suportit me telefon ose në ambientet e klientit, pa pagesë për pjesët e këmbimit ose për punën e kryer;

8.2. zëvendësimin e produktit me një produkt të njëjtë ose të krahasueshëm, të përdorur ose të ri. Produkti i krahasueshëm mund të ketë ndryshime të vogla në dizajn ose në specifikime, të cilat nuk ndikojnë në funksionalitetin e tij sipas qëllimit të klientit. Në rastin e produktit të përdorur, ai është kaluar më parë në servis për t'u kthyer në cilësimet e fabrikës, është pastruar dhe kontrolluar për defekte;

8.3. rimbursimin e shumës së paguar për produktin pas kthimit të tij, me një ulje të arsyeshme për kohën e përdorimit.

9. Zgjedhja mes këtyre opsioneve i takon ekskluzivisht RATECH. Riparimi dhe zëvendësimi i produktit nuk janë shkak për fillimin e një periudhe të re garancie apo për zgjatjen e garancisë ekzistuese. Nëse periudha e garancisë nuk ka përfunduar, ajo është e vlefshme deri në përfundimin e afatit. RATECH mund t'i faturojë klientit kostot e arsyeshme që i janë shkaktuar nga ankesa për një produkt që nuk rezultoi me defekt, duke përfshirë kosto transporti, testimi apo analizimi.

10. Përveç rastit kur produkti është instaluar nga RATECH, garancia nuk mbulon çmontimin, çinstalimin, heqjen dhe zëvendësimin e produktit, strukturave ose pjesëve të tjera të objektit të klientit, pastrimin dhe instalimin nga e para të produktit. Klienti është përgjegjës për mbulimin e kostove të këtyre aktiviteteve, përfshirë kostot e aksesit me qëllim që RATECH të realizojë garancinë. RATECH mund t'i faturojë klientit edhe kostot që kanë ardhur nga aktivitete të ngjashme, të kryera për të realizuar garancinë e një produkti të instaluar nga RATECH, në rast se produkti rezulton pa defekt.

11. Detyrimet e RATECH sipas kësaj garancie zbatohen vetëm për produktet e listuar në Tabelën 1. RATECH nuk ofron asnjë garanci për asnjë produkt tjetër, përfshirë produkte të palëve të treta apo produkte që nuk mbajnë marka, për të cilat RATECH ka autorizimin e shpërndarjes ose shitjes. Po ashtu, kjo garanci nuk mbulon komponentët e zëvendësueshëm, edhe kur ato janë furnizuar fillimisht nga RATECH. RATECH nuk ofron asnjë garanci apo suport për rrjete, sisteme apo *software*, me të cilët mund të jetë lidhur produkti, edhe nëse specifikimet teknike të produktit përmbajnë referenca tek këto. RATECH, gjithashtu, nuk ofron asnjë garanci për defektet që kanë ardhur si rezultat i gabimeve në skica, udhëzime ose specifikime të dhëna nga klienti.

12. Kjo garanci nuk mbulon përditësimin e *software*-ve pa pagesë, edhe kur *software* është instaluar nga RATECH, dhe as cilësinë e lidhjes në rrjet. Çdo kosto që lidhet me mbajtjen e sistemeve të përditësuar dhe me lidhjen në rrjet i takon klientit.

13. RATECH nuk ka asnjë detyrim sipas kësaj garancie nëse zbulohet se defekti i pretenduar ka ndodhur si rezultat i:

13.1. forcës madhore;

13.2. kushteve të furnizimit me energji elektrike, përfshirë luhatjet në elektricitet, rritjen ose pakësimin e voltazhit, sistemet e kontrollit të luhatjeve apo sistemet alternative të furnizimit me energji që tejkalojnë kufijtë e specifikuar të produktit dhe ato të përcaktuara nga standardet përkatëse të furnizimit për secilin produkt;

13.3. kabllimit, instalimeve elektrike, ndryshimit të parametrave të paravendosur të produktit, mirëmbajtjes jo të përshtatshme, si dhe defekteve që vijnë nga komponentët apo aksesorët që nuk mbulohen nga kjo garanci;

13.4. mosrespektimit të udhëzimeve të dhëna nga RATECH, nga dokumentat që shoqërojnë produktin apo nga standardet e zbatueshme industriale për instalimin, vënien në punë, përdorimin apo mirëmbajtjen e produktit;

13.5. përdorimit të produktit për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është krijuar;

13.6. vendosjes së produktit në ambiente gërryese, përdorimit të tepruar, pakujdesisë, neglizhencës, aksidenteve, abuzimit, keqpërdorimit, përdorimit të papërshtatshëm apo jonormal të produktit;

13.7. çdo përpjekjeje për riparim, ndryshim ose modifikim që nuk ka qenë autorizuar me shkrim nga RATECH.

14. Kjo garanci standarde, e marrë së bashku me termat, përbën marrëveshjen e plotë të garancisë për çdo produkt me defekt dhe zëvendëson të gjitha deklaratat ose komunikimet paraprake, me gojë dhe me shkrim, bërë me klientin për këtë produkt. Për aq sa lejohet nga ligji, garancitë e përfshira këtu janë garancitë e vetme të dhëna nga RATECH në lidhje me produktin. Klienti nuk do të mbështetet në ndonjë informacion tjetër për produktin apo performancën e tyre, të dhënë nga RATECH ose nga burime të tjera, apo në fakte të njohura përgjithësisht në industrinë e ndriçimit. Të vetmet mjete të mbrojtjes së klientit nga çfarëdo lloj defekti janë ato që përshkruhen në këtë garanci standarde.

15. RATECH mund ta ndryshojë këtë garanci standarde herë pas here dhe çdo ndryshim është i vlefshëm për blerjet e bëra pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve.